



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2210/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI160/22

Parashtrues

Asllan Kika

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 574/2021] të 2 qershorit
2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Asllan Kika me vendbanim në Prishtinë, i cili përfaqësohet nga Jeton Osmani, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 574/2021] të 2 qershorit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 6068/2020] të 16 marsit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), si dhe Aktgjykimin [C.nr. 576/19] e 19 qershorit 2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 16 qershor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetua), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 31 tetor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga i njëjti që të dorëzonte autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 31 tetor 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës si dhe i ofroi të njëjtës një kopje të kërkesës.
10. Më 14 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë, duke theksuar që: *“Andaj edhe në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenit 32 pika C e Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese e njëjta më ka autorizuar që të jem përfaqësues i saj dhe me të njëjtin autorizim kam përfaqësuar në gjithë procedurën Gjyqësore”*.
11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes se Republikës së Kosovës, me ç’ rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

12. Më 2 mars 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ta njoftojë Gjykatën lidhur me datën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
13. Më 7 prill 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dorëzimin e dosjes së plotë.
14. Më 13 prill 2023, Gjykata Themelore e dorëzoi dosjen e lëndës në Gjykatë.
15. Më 23 maj 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

16. Parashtruesi i kërkesës kishte punuar në ndërmarrjen Kompania Kosovare për Distributum dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS Sh.A.) deri më 7 shtator 2018, kur edhe ishte pensionuar me gjithsej përvojë të punës prej 41 vitesh e 9 muaj, prej të cilave 36 vjet e 5 muaj jashtë të paditurës, ndërsa tek e paditura 5 vjet e 4 muaj.
17. Më 28 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi kundër të paditurës "KEDS-Sh.A." për shpërblimin e pagave jubilarë dhe përcjelljes në pension, ashtu që edhe gjatë seancës për shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, t'ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar shumë të tërësishme prej 4007.10 Euro, me kamate prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë si dhe në të njëjtin afat të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës.
18. Më 19 qershor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.576/19]: (I) refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kërkonte që të detyrohet e paditura-"KEDS-Sh.A" që paditësit t'ia kompensojë në emër të tri pagave për shpërblim jubilar shumë prej 2003.55 euro dhe tri paga për përcjellje në pension shumë prej 2003.55 euro, gjithsej shumë prej 4007.10 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ndërprerjes së punës, më 7 shtator 2018, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ligjor; (II) Secila palë i bartë shpenzimet e veta.
19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë: (i) për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe për shkak të (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore, ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës si e bazuar.
20. Më 16 mars 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 6068/2020] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.576/19] e 19 qershorit 2019. Në aktgjykimin e saj Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim: *"Paditësi nuk i është drejtuar të paditurës me kërkesë për realizimin e pagës jubilarë, e poashtu gjykatës nuk i është prezantuar asnjë dokument ose kërkesë me të cilën paditësi i është drejtuar të paditurës për realizimin e pagës jubilarë, e cila do ta ndërpriste afatin e parashkrimit, ndërkaq padinë e ka paraqitur në gjykatë të shkallës së parë me datë 28.02.2019, e që rezultoi se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë, pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet se "Te gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. ", dhe se bazuar në gjendjen faktike*

paditësi ka arritur përvojën e punës 30 vjeçare me datë 21.10.2005, mirëpo atëkohë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 kështu që afati i fundit për paraqitjen e kërkesës do të kishte qenë brenda periudhës tri vjeçare që i bie data deri më 31.12.2017. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 357 par. 1 i LMD-së, në të cilin citohet se "Kërkesa për shpërblim të dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dënimin për dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëmin", i bie se këtu paditësit me hyrjen në fuqi të MPKK datë 01.01.2015 iu është njohur e drejta për të paraqitur kërkesën e tij, andaj si datë e fundit do të kishte qenë data 31.12.2017, që nënkupton se ushtrimi i padisë në gjykatë nga ana e paditësit në shkurt të 2019 rezultoi se ka kaluar afati i paraparë ligjor dhe se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar".

21. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranojë si të bazuar revizionin, ndërsa aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, t'i ndryshojë ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.
22. Më 2 qershor 2022, Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit [Rev.nr.574/21] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.6068/20], të 16 marsit 2021. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim: "Gjykata Supreme e vlerësoi të pabazuar pretendimin e paditësit se kërkesa e tij nuk është parashkruar, për arsye se: në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës - Ligji nr. 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", dhe duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rrjedh se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar, për faktin se paditësi ka arritur përvojën e punës 30 vjeçare me datë 21.10.2005, dhe në këtë kohe nuk ka qenë në fuqi, Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014, e lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015. Po ashtu nga momenti kur kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 e deri në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 28.02.2019, kanë kaluar mbi 3 vite, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNj-së.
24. Në vijim, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë: (i) me shkelje të nenit 31 të lidhur me nenin 102 të Kushtetutës, për sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit material, sepse është interpretuar gabimisht neni 87 i Ligjit të punës me rastin e refuzimit të kërkesës së tij, si të parashkruar, dhe moszbatim të duhur të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës; (ii) pretendimin për mohimin e mjeteve juridike në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës, të ndërlidhur me nenin 54 të Kushtetutës; si dhe (iii) pretendimet për

moskonsistencë të praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe shkeljeve të tjera të të drejtave kushtetuese të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës.

25. Për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 102 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimet e atakuara janë kundërligjore dhe në tërësi të paqëndrueshme. Parashtruesi pretendon që gjykatat e rregullta nuk i kanë arsyetuar vendimet gjyqësore kur kanë vendosur lidhur me kërkesëpadinë e tij, duke mos e arsyetuar: *“[...] bazën juridike se pse refuzohej kërkesëpadia për sa i përket pagave përcjellëse me rastin e pensionimit kur e paditura këtë e ka të rregulluar edhe me aktet e brendshme të saj përkatësisht me nenin 46 par.3 të Kodit të punës së KEDS, e kur nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësit marrëdhënia e punës ju ka ndërprerë sipas fuqisë ligjore me rastin e pensionimit. Në të gjitha aktgjykimet është arsyetuar vetëm baza juridike për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me pagat jubilarë, edhe pse të njëjtat janë refuzuar në tërësi pa kurrfarë baze juridike pasi që nuk kemi pasur të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë apo mos zbatim të Marrëveshjes Kolektive të Kosovës në kohën kur paditësi e ka fituar të drejtën për shpërblim jubilar”.*
26. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta kanë bërë: *“[...] zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe zbatim jo të drejtë të dispozitës së nenit 52 dhe 53 të MPKK por edhe në nenin 46 par.3 të Kodit të punës së të paditurës [...]”.*
27. Parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta gabimisht kanë konstatuar që padia e tij ishte parashkruar në kuptim të dispozitave të nenit 87 të Ligjit të punës, ngase në këtë nen qartë specifikohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.*
28. Në vijim, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se: *“Për më tepër meqenëse dispozitat e MPKK nuk parashohin shpërblim jubilar për arritjen e përvojës për vitin e 40 jubilar, por as edhe me një dispozitë të vetme të legjislacionit në fuqi nuk është rregulluar apo ndaluar kjo çështje juridike për këtë kategori të të punësuarve atëherë paditësi me të drejt konsideron se meqenëse viti i 40 i përvojës është vit jubilar atëherë gjykata duhet të aplikoj dispozitën që është më e përafërt dhe që i përgjigjet kësaj gjendje faktike. Pra duhet të aplikohet dispozitat e nenit 52 par. 1.1.3 dhe paditësit ti njihet e drejta në tri paga jubilarë ashtu siç janë precizuar në padi”.*
29. Parashtruesi i kërkesës poashtu thekson se përveç që i është pamundësuar marrja e një përgjigjeje përfundimtare dhe të drejtë për meritat e rastit të tij, i njëjti pretendon se i janë shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së. Në ndërlidhje me këtë parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta kanë vepruar në shkelje të nenit 102 të Kushtetutës, duke mos vepruar në bazë të ligjit të aplikueshëm siç kërkohet me Kushtetutë.
30. Në vijim, parashtruesi i kërkesës për sa i përket pretendimin për vendimit të padrejtë gjyqësor, të njëjtin e ndërlidh edhe me pretendimet për (ii) mohimin e mjeteve juridike, që konsistojnë me shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNj-së.
31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ngrit pretendime për sa i përket (iii) moskonsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, të cilat sipas parashtruesit kishin vendosur raste të ngjashme duke i aprovuar ato, rrjedhimisht me këto veprime tashmë kanë shkaktuar pasiguri juridike, duke e vënë parashtruesin e kërkesës në pozitë të pabarabartë para ligjit në kuptim të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës. Lidhur me këtë pretendim të tij parashtruesi thekson si në vijim: *“Si*

Gjykata Supreme ashtu edhe Gjykata e Apelit disa herë kanë vendosur për raste të ngjashme si të paditësit duke aprovuar në tërësi paditë e paditësve të ngritura pikërisht ndaj të paditurës KEK sh.a si në rastin me numër CML.Nr. 7/2020, dt.215.04.2021, Rev.nr.90/2020 dt.04.05.2020, Ac.nr.4367/19 dt.17.07.2020, Acnr.2016/2020, dt.24.06.2020 por gjithashtu ka edhe me qindra Aktgjykime të tilla të cilat Gjykata e Apelit veçse i kanë njohur këto të drejta me kushte të njëjta si të paditësit”.

32. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me Kushtetutë, dhe se i njëjti: “[...]pret mbrojtje juridike nga Gjykata Kushtetuese me vërtetimin e kërkesës së saj”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 32 **[E Drejta për Mjete Juridike]**

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54 **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 102 **[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga

gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Neni 13 **E drejta për zgjidhje efektive**

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkëlja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 87 **Afati i parashkrimit**

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 90 **Marrëveshja Kolektive**

[...]

4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.”

MARRËVESHJA E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE E KOSOVËS

Neni 52 **Shpërblime jubilarë**

1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:

1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij;

1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;

1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.

2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.

3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf

[...]

Neni 53 **Kompensimi në rast të pensionimit**

I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit.

Neni 82

1. Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, hyn në fuqi nga data 01.01.2015

Mendim Juridik për Shpërblimin Jubilar i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 27 shkurtit 2023

Marrëveshja/Kontratat e aplikueshme

“II. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me date 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e me tejme: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet ne periudhën kohore nga data 01.1.2015 - 31.12.2017.”

Kushtet për të fituar të drejtën shpërblimit jubilar:

“VI. I punësuari ne bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10,20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10,20 dhe 30 vjet duhet të jete e pandërprere të punëdhënësi i fundit.”

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

35. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

36. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.574/2021] të 2 qershorit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
37. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GjEDNj-së, [Kemachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii)).

39. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
40. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 3, 24, 31, 32, 54, dhe 102 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së.
41. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me pretendimet për: (i) shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 102 të Kushtetutës, për sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit material, sepse është interpretuar gabimisht neni 87 i Ligjit të punës me rastin e refuzimit të kërkesës së tij, si të parashkruar, si dhe moszbatim të duhur të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës; (ii) pretendimin për mohimin e mjeteve juridike në kundërshtim me nenin 32 të ndërlidhur me nenin 54 të Kushtetutës; si dhe (iii) pretendimet për *moskonsistencë të praktikës gjyqësore* të gjykatave të rregullta dhe shkeljeve të tjera të të drejtave kushtetuese të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës.

(i) Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 102 të Kushtetutës, për sa i përket interpretimit të gabuar të ligjit

42. Parashtruesi i kërkesës, i konteston para Gjykatës konstatimet e gjykatave të rregullta duke pretenduar shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 102 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, vë theks në arsyetimin e bazës juridike të refuzimit të kërkesëpadisë së tij, pasi që pretendon që gjykatat e rregullta kanë bërë zbatim të gabuar të nenit 52 dhe 53 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, nenit 46 par.3 të Kodit të punës së të paditurës, si dhe konstatimit të gabuar se padia e tij ishte parashkruar në kuptim të dispozitave të nenit 87 të Ligjit të punës. Prandaj, i njëjti pretendonte që atij i janë shkelur garancitë procedural të nenit 31 të Kushtetutës.
43. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se të njëjtat në esencë ndërlidhen me zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, pretendime këto që Gjykata i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*", në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GjEDNj-së. Rrjedhimisht, Gjykata rikujton qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimet përkatëse të dispozitave ligjore a ligjit, si rregull hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, dhe, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë "*e shkallës së katërt*" (shih, në lidhje me doktrinën e "*shkallës së katërt*", rastin e GjEDNj-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës \[DHM\], nr. 30544/96](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
44. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNj-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNj (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI06/21](#), parashtrues *Xhelal Zherka*, Aktvendim për

Papranueshmëri i 23 shtatorit 2021, paragrafi 49; [KI145/20](#), parashtrues *Hafize Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 33; [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KIO5/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

45. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se interpretimi i së drejtës materiale dhe procedurale është detyrë parësore dhe bie brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në përputhje me normativat dhe standardet kushtetuese.
46. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, fillimisht Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.576/2019] të 19 qershorit 2019, kishte theksuar si në vijim: *"Padiësi është pensionuar me datë 07.09.2018, në kohën kur marrëveshja kolektive nuk ka qenë në fuqi. Ndërsa Kodi i Punës së të paditurës në dispozitën e nenit 46 par.3 ka paraparë që: Nëse financat mundësojnë KEDS sipas diskrecionit të tij absolut, do të bëjë pagesë ex gratia për punëmarrësit që kanë arritur moshën ligjore të pensionimit dhe kanë të paktën 5 vite përvojë paraprake të punës në KEDS. Pagesa do të jetë shumë e gatshme e barabartë me tri paga mujore bazë të punëmarrësit, me kusht, sidoqoftë, asnjë pagesë nuk do të bëhet deri në datën e shkëputjes së marrëdhënies së punës së punëmarrësit me KEDS. Padiësi me provat e prezantuara të cilat janë administruara nga ana e gjykatës nuk mundi të argumentoj kërkesën e tij në raport me të paditurën, më konkretisht me asnjë provë nuk mundi ta argumentoj se i takon e drejta në pagesë me rastin e pensionimit e as për shpërblimin jubilar të pretenduar me padi, me çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi"*.
47. Në vijim, për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren që Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.6068/2020] të 16 marsit 2021, kishte theksuar si në vijim: *"Padiësi nuk i është drejtuar të paditurës me kërkesë për realizimin e pagës jubilarë, e poashtu gjykatës nuk i është prezantuar asnjë dokument ose kërkesë me të cilën padiësi i është drejtuar të paditurës për realizimin e pagës jubilarë, e cila do ta ndërpriste afatin e parashkrimit, ndërkaq padinë e ka paraqitur në gjykatë të shkallës së parë me datë 28.02.2019, e që rezulton se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë, pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet se "Te gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.", dhe se bazuar në gjendjen faktike padiësi ka arritur përvojën e punës 30 vjeçare me datë 21.10.2005, mirëpo atëkohë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 kështu që afati i fundit për paraqitjen e kërkesës do të kishte qenë brenda periudhës tri vjeçare që i bie data deri më 31.12.2017. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 357 par. 1 i LMD-së, në të cilin citohet se "Kërkesa për shpërblim të dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëmin", i bie se këtu padiësit me hyrjen në fuqi të MPKK datë 01.01.2015 iu është njohur e drejta për të paraqitur kërkesën e tij, andaj si datë e fundit do të kishte qenë data 31.12.2017, që nënkupton se ushtrimi i padisë në gjykatë nga ana e padiësit në shkurt të 2019 rezulton se ka kaluar afati i paraparë ligjor dhe se kërkesëpadia e padiësit është parashkruar"*.
48. Në këtë rast konkret, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [Rev.nr.574/2021], të 2 qershorit 2022, të Gjykatës Supreme si instancë përfundimtare

në këtë çështje civile, dhe vëren se e njëjta ka shpjeguar në detaje arsyet e refuzimit të disa prej kërkesave të ngritura në revizion nga parashtruesi i kërkesës, duke arsyetuar se: *“Gjykata Supreme e vlerësoi të pabazuar pretendimin e paditësit se kërkesa e tij nuk është parashkruar, për arsye se: në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës - Ligji nr. 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, dhe duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rrjedh se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar, për faktin se paditësi ka arritur përvojën e punës 30 vjeçare me datë 21.10.2005, dhe në këtë kohe nuk ka qenë ne fuqi, Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014, e lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015. Po ashtu nga momenti kur kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 e deri në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 28.02.2019, kanë kaluar mbi 3 vite, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar”.*

49. Nën dritën e të lartcekurave, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin sqaruar se: (i) parashtruesi i kërkesës kishte plotësuar kushtin për shpërblimin jubilar (përvojë pune 30 vjeçare më 21 tetor 2015) para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës; (ii) Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ishte e aplikueshme në periudhën 1 janar 2015, deri më 31 dhjetor 2017; (iii) parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesën për kompensimin e shpërblimit jubilar me 28 shkurt 2019, respektivisht pas skadimit të aplikueshmërisë së Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës; si dhe (iv) kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave jubilarë ishte parashkruar tashmë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës.
50. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke arsyetuar çështjen se përse në rastin e tij nuk mund të plotësohej kërkesa e tij për kompensimin e pagave jubilarë si rezultat i mungesës së bazës ligjore në kuptim të mos aplikueshmërisë së Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe si rezultat i parashkrimit të kërkesës, si dhe duke aplikuar dispozita përkatëse të Ligjit të punës që ato i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret.
51. Përveç elaborimeve të lartcekura, Gjykata gjen se vendimmarrja e Gjykatës Supreme, në rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret është në pajtueshmëri edhe me mendimin juridik për shpërblimin jubilar të nxjerrë nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, e 27 shkurtit 2023. Në këtë drejtim, Gjykata do t'i referohet pjesës relevante të Mendimit Juridik të 27 shkurtit 2023 të Gjykatës Supreme, i cili përcakton se: *“VI. I punësuar i në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik [Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës aplikohet në periudhën kohore nga data 01.12.2015- 31. 12. 2017]; dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit”.*
52. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo për barazi para ligjit (shih, *mutatis mutandis*, rastin [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë, kërkesa nr. 5503/02](#),

GjEDNj, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; shih gjithashtu rastin e Gjykatës: KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaq*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

53. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e "*shkallës së katërt*" dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të "*ligjshmërisë*" dhe nuk janë argumentuar në nivel të "*kushtetutshmërisë*". Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me pretendimin për mohimin e mjeteve juridike në kundërshtim me nenin 32 në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës

54. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se refuzimi i revizionit si i pabazuar dhe mosshqyrtimi i rastit të parashtruesit në merita nga Gjykata Supreme ka ndodhur si pasojë e aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe rrjedhimisht kjo ka shkaktuar shkelje të nenit 32 në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, të ndërlidhur me nenin 13 të KEDNj-së.
55. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte përdorur mjetin juridik – revizionin kundër Aktgjykimit [Ac.nr.6068/2020] të Gjykatës së Apelit, të 16 marsit 2021 duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zbatim të gabuar të se drejtës materiale.
56. Gjykata vëren se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.574/2021] të 2 qershorit 2022, kishte shqyrtuar rastin dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe në fund kishte refuzuar revizionin e paraqitur si të pathemeltë me arsyetimin se nuk kishte gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për të aprovuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe se nuk ekzistonin shkaqet e cekura në revizionin e paraqitur në kuptim të neneve 211, 212 dhe 215 të Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore.
57. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka përdor mjetin juridike revizionin si dhe ka pasur mundësinë që të ngritë pretendime lidhur me kërkesën e tij, si dhe Gjykata Supreme iu kishte përgjigjur pretendimeve të ngritura në kërkesë duke dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme e duke shtjelluar në detaje bazën ligjore për refuzimin e revizionit të paraqitur.
58. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të parashtronte argumente dhe dëshmi që ai i ka konsideruar të rëndësishme për rastin e tij; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka gëzuar garancitë procedurale të ngërthyera në konceptin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI118/17](#), parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih rastin e GjEDNj-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

59. Duke u mbështetur në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata konstaton se edhe ky pretendim i parashtruesit të kërkesës bie në kategorinë e tretë (iii), pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj Gjykata, si të tilla, në baza kushtetuese i deklaroi qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(iii) Përkitazi me pretendimet për moskonsistencë të praktikës gjyqësore të ndërlidhura me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës

60. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për moskonsistencë të praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta, të cilat i ndërlidh me shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, i njëjti konsideron se gjykatat e rregullta: “[...] kishin vendosur për raste të ngjashme si të paditësit duke aprovuar në tërësi paditë e paditësve të ngritura pikërisht ndaj të paditurës KEK sh.a si në rastin me numër CML.Nr. 7/2020, dt.215.04.2021, Rev.nr.90/2020 dt.04.05.2020, Ac.nr.4367/19 dt.17.07.2020, Acnr.2016/2020, dt.24.06.2020 por gjithashtu ka edhe me qindra Aktgjykime të tilla të cilat Gjykata e Apelit veçse i kanë njohur këto të drejta me kushte të njëjta si të paditësit.”
61. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata sqaron se parashtruesi i kërkesës nuk kishte sjellë asnjërin nga vendimet e lartcekura, si dhe nuk kishte ofruar analizën krahasimore të ngjashmërive faktike dhe juridike të rasteve në fjalë me rrethanat e rastit të tij.
62. Prandaj duke përfshirë pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, të ndërlidhura me pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii), pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rasti i GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim) nr. 4241/03* i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim) nr. 6032/04* i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin *KI166/20*, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42).
63. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm e përmend nenin përkatës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës

duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [KI136/14](#), parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 33; [KI187/18](#) dhe [KI11/19](#), parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; dhe së fundmi rastin [KI125/19](#) parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63).

64. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrëjë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GjEDNj-së, [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
65. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet qartazi e pabazuar, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht i përmend këto dispozita të Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

66. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e sipër cekura të Kushtetutës dhe të KEDNj-së, janë qartazi të pabazuara, sepse pretendimet për (i) shkelje të nenit 31 në ndërlidhje me nenin 102 të Kushtetutës, cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së “*shkallës së katërt*”; (ii) pretendimet për mohimin e mjeteve juridike në kundërshtim me nenin 32 në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës si dhe (iii) pretendimet e tjera për shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, kategorizohen si pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” në baza kushtetuese.
67. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa, në tërësinë e saj, deklarohet qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani